



BASHKIA
TIRANË

=

Drejtuar: Shoqërisë “Communication Pogress” shpk
Adresa: Rruga “Dritan Hoxha”, Pallati M.C Inerte, kati I, Laprakë, Tiranë.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: e zgjedhur në bazë të Nenit 30 të Ligjit Nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu IV, Neni 33 është **“Procedurë e hapur”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Forcimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit ne Bashkine e Tiranës”**.

Fondi limit: **43.080.000 (dyzet e tremilion e tetëdhjetëmijë)** lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Të ardhura - fonde të vëna në dispozicion nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve me anë të vendimit Nr. 38 dt 13.07.2016 për ”Shpërndarjen e financimit për projekte të reja, nga granti ”Shqipëria Dixhitale”, në programin e Infstrukturës Vendore dhe Rajonale” si dhe nga Buxheti i Bashkisë Tiranë me anë të VKB-së Nr 59 dt 25.07.2016 për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr.58, datë 30.12.2015 ”Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2016” me objekt: **“Forcimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit në Bashkinë e Tiranës”**. Referuar burimit të financimit sa më sipër cituar, Vlera e financimit per vitin 2016 në shumën prej **25.000.000 (njëzet e pesë milion) lekë pa tvsh** është vlera e financimit që alokohet nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve per vitin 2016 që përfaqëson koston e zhvillimit dhe implementimit të projektit ndërsa vlera e financimit nga Bashkia Tiranë në shumën prej **18.080.000 (tetëmbëdhjetë milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa tvsh** përfaqëson koston e mirëmbajtjes për 4 vite.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **16.12.2016 ora 12.00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 45 datë 14.09.2016.**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik **“Bylis Pharma” shpk**

NUIS- S'ka

S'ka paraqitur ofertë ekonomike.

2. Operatori ekonomik “C.C.S” shpk

NUIS J61901033C

S'ka paraqitur ofertë ekonomike

3. Operatori ekonomik “Communication Progress” shpk

NUIS K01625001C

Vlera e ofertës pa TVSH është **37.990.000 (tridhjetë e shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë.**

4. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Infosoft Systems” & “ikubINFO” shpk

NUIS J61820021C & L11712002T

Vlera e ofertës pa TVSH është **36.104.540 (tridhjetë e gjashtë milion e njëqind e katërmijë e pesëqind e dyzet) lekë.**

5. Operatori ekonomik “Intracom Telecom Albania” shpk

NUIS K12006001H

Vlera e ofertës pa TVSH është **42.680.000 (dyzet e dymilion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) lekë.**

6. Operatori ekonomik “iCOM” shpk

NUIS- L12402023H

Vlera e ofertës pa TVSH është **38.700.000 (tridhjetë e tetë milion e shtatëqind mijë) lekë**

7. Operatori ekonomik “IMB- Instituti i Modelimeve ne Biznes” NUIS K0141000N

Vlera e ofertës pa TVSH është **42.953.200 (dyzet e dymilion e nëntëqind e pesëdhjetë e tremijë e dyqind) lekë**

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm

1 Operatori ekonomik “Bylis Pharma” shpk s’kualifikohet.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme.

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Bylis Pharma” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar tek kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “Bylis Pharma” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Infosoft Systems” & “ikubINFO” shpk s’kualifikohet

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

I. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “INFOSOFT SYSTEMS”& “ikubINFO”, për plotësimin e kriterëve të vecanta të kualifikimit të kërkuara sipas pikës 2/3/10.4 “Kapaciteti teknik/stafi teknik i çertifikuar,” ka paraqitur dokumentacion si më poshtë:

1.Denisa Bakollari

Çertifikatë Softëare Business Analyst

Çertifikatë Erp Concept

Çertifikatat e mësipërme të paraqitura nuk mbulojnë kompetencat Analist në teknologjinë ERP Microsoft Dynamics NAV të paraqitura në propozimin teknik.

CV

Kontratë Pune

2.Jonela Dhamo

Çertifikatë Softëare Business Analyst

Çertifikatë Erp Concept

Çertifikatat e mësipërme të paraqitura nuk mbulojnë kompetencat Analist në teknologjinë ERP Microsoft Dynamics NAV të paraqitura në propozimin teknik.

CV

Kontratë Pune

Për sa më sipër, gjykojmë se Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “INFOSOFT SYSTEMS”& “ikubINFO”, nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim sipas pikës 2/3/10.4 “Kapaciteti teknik/stafi teknik i çertifikuar,” në lidhje me certifikimin e të paktën 2(dy) punonjës me eksperiencë pune të çertifikuar Analist të teknologjisë ERP që do të paraqitet në propozimin teknik.

II. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “INFOSOFT SYSTEMS”& “ikubINFO”, për plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit të kërkuara sipas pikës 2/3/10.5 “Kapaciteti teknik/”, pika 5 (stafi teknik i çertifikuar), ka paraqitur dokumentacion si më poshtë:

1.Denisa Bakollari

Çertifikatë Erp Concept

Çertifikata e mësipërme e paraqitur nuk mbulon kompetencat për zhvillimin dhe implementimin në teknologjinë ERP Microsoft Dynamics NAV të paraqitur në propozimin teknik.

CV

Kontratë Pune

2.Jonela Dhamo

Çertifikatë Erp Concept

Çertifikata e mësipërme e paraqitur nuk mbulon kompetencat mbi zhvillim dhe implementim në teknologjinë ERP Microsoft Dynamics NAV të paraqitur në propozimin teknik.

CV

Kontratë Pune

3.Anisa Hoxha

Çertifikatë Financial Accounting

Çertifikata e mësipërme e paraqitur nuk mbulon kompetencat mbi zhvillim dhe implementim në teknologjinë ERP Microsoft Dynamics NAV të paraqitur në propozimin teknik.

Kontratë Pune

4.Esnida Trebicka

Çertifikatë Erp Concept

Çertifikata e mësipërme e paraqitur nuk mbulon kompetencat mbi zhvillim dhe implementim në teknologjinë ERP Microsoft Dynamics NAV të paraqitur në propozimin teknik.

CV

Kontratë Pune

5.Gertian Brahimaj

Transcript Microsoft- MCSA eeb applications

Çertifikata e paraqitur nuk mbulon kompetencat mbi zhvillim dhe implementim në teknologjinë ERP Microsoft Dynamics NAV të paraqitur në propozimin teknik.

CV

Kontratë Pune

6.Arsela Vangjeli

Transcript Microsoft- MCSA ëeb applications

Çertifikata e mësipërme e paraqitur nuk mbulon kompetencat mbi zhvillim dhe implementim në teknologjinë ERP Microsoft Dynamics NAV të paraqitur në propozimin teknik.Vlefshmëria e MSCA ëeb applications deri më dt.20.10.2016.

CV

Kontratë Pune

7.Olsi Zotaj

Transcript Microsoft- MCSA ëeb applications

Çertifikata e mësipërme e paraqitur nuk mbulon kompetencat mbi zhvillim dhe implementim në teknologjinë ERP Microsoft Dynamics NAV të paraqitur në propozimin teknik. Kopja e përkthyer e paraqitur për çertifikatën MCSA ëeb applications nuk përputhet me origjinalin (përkthimi e ka datën e vlefshmërisë deri më 22.06.2016, origjinali deri më dt.22.06.2017).

CV

Kontratë Pune

*Për sa më sipër, gjykojmë se **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “INFOSOFT SYSTEMS”& “ikubINFO”**, nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim sipas pikës 2/3/10.5 “Kapaciteti teknik/stafi teknik i certifikuar,” në lidhje me certifikimin e të paktën 3 (tre) punonjësve për zhvillim dhe implementim të teknologjisë ERP që do të paraqitet në propozimin teknik.*

III. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “INFOSOFT SYSTEMS”& “ikubINFO”, për plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit të kërkuara sipas pikës 2/3/10 “Kapaciteti teknik/stafi teknik i certifikuar”, ka paraqitur dokumentacion si më poshtë:

Për stafin teknik të certifikuar janë paraqitur Kontrata Individuale Pune, të cilat kanë mangësi në përmbajtjen e tyre, konkretisht nuk janë bashkëngjitur Aneksi 2. Në kontrata e punës të paraqitura citohet “Dispozitat e kësaj kontrate hyjnë në fuqi në datën e përcaktuar në Aneksin 2, bashkëngjitur”.

IV. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “INFOSOFT SYSTEMS”& “ikubINFO”,për plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit të kërkuara sipas pikës 2/3/2 “Kapaciteti teknik” ka paraqitur dokumentacion si më poshtë:

Operatorit Ekonomik “ikubINFO” ka paraqitur Konfirmim të Statusit të Microsoft

Partner për kompetencën GOLD për Zhvillim Aplikacionesh dhe Integrim

Sistemesh.

Operatori Ekonomik “Infosoft Systems” ka paraqitur Konfirmim të Statusit të

Microsoft Partner për kompetencën SILVER për Zhvillim Aplikacionesh dhe

Integrim Sistemesh.

Për sa më sipër, gjykojmë se Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “INFOSOFT SYSTEMS”&“ikubINFO”, përfaqësuar nga Operatori ekonomik “INFOSOFT SYSTEMS”, nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim sipas pikës 2/3/2 “Kapaciteti teknik,” në lidhje me Kompetencën GOLD për Zhvillim Aplikacionesh dhe Integrim Sistemesh, nga Microsoft, pasi Operatori ekonomik “INFOSOFT SYSTEMS” ka (85%) të zërit “Sistemi i menxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë e Tiranës (zhvillim sistemi, trajnim, instalim), siç parashikohet në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Neni 74, ku citohet “Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

V. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “INFOSOFT SYSTEMS”& “ikubINFO”,

për plotësimin e Propozimit teknik të detajuar sipas termave të referencës ka paraqitur dokumentacion si më poshtë:

- Oferta teknike Bashkia Tiranë
- Konfirmim për terma reference
- Dokumenti i testeve të pranimit
- Shërbimet dhe Grafiku I ekzëekutimit
- Axxhendë trajnimi,
- Gant Chart
- Gant Chart(1)

Referuar dokumentacionit të mësipërm të paraqitur, gjykojmë se Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “INFOSOFT SYSTEMS”& “ikubINFO” nuk plotëson kërkesat teknike referuar termave të referencës me argumentat si më poshtë vijon:

1.Nuk plotësohen kërkesat e parashikuara në paragrafin 4.2 Detyrat specifike/ Faza I/ faqe

nr.10 e termave të referencës, pasi :

- ka mangësi në përmbushjen e kërkesës për analizën e plotë të proceseve të punës dhe aktorëve nëpërmjet diagramave UML, mungon diagrama UML për modulën e Buxhetit, diagrama UML për menaxhimin e arkës nuk shpreh qartë kuptimin e proceseve të organizimit të arkës.
- ka mangësi të screenshots të sistemit të propozuar për disa kërkesa funksionale mungojnë screenshots për modulet Qendra Kosto, Buxheti, Listë-Pagesa dhe Administrimi.
- Në formën Gantt Chart të propozuar, nuk janë paraqitur të gjitha fazat e parashikuara në termat e referencës, mungon faza e migrimit të të dhënave dhe trajnimit.

Mosparaqitja e dokumentave të mësipërm teknikë, sipas kriterëve të kërkuara, përbën kusht për skualifikim të ofertës së operatorit.

2. Nuk plotësohen kërkesat e parashikuara në paragrafin Kërkesat teknike të aplikacionit softëare:

pika 006, faqe nr.54 e termave të referencës, sistemi i ofruar Microsoft Dynamics NAV, sistemi i ofruar nuk është i pavarur nga sistemi operativ. Si kërkesë e këtij sistemi është instalimi në një ambient me sistem operativ Ëindoës, referuar linkut publik të Microsoft ku përshkruhen kërkesat për instalimin e tij.

- pika 006, faqe nr.54 e termave të referencës, serveri I databazës MS SQL Server Express Edition nuk është i pavarur nga sistemi operativ. Si kërkesë e këtij sistemi është instalimi në një ambient me sistem operativ Ëindoës, referuar linkut publik të Microsoft ku përshkruhen kërkesat për instalimin e tij.
- pika 015, faqe nr.55 e termave të referencës, zgjidhja teknike e ofruar nuk plotëson kërkesën për ruajtje të dokumentave në databazë, pasi dokumentat e scanuara janë në range të MB. Duke qenë se madhësia maksimale e databazës MS SQL Server Express Edition është 10 GB, në këtë databazë mund të hidhen përafërsisht rreth 1000 dokumenta, pra ka kufizim të ndjeshëm në numrin e dokumentave që do të ruhen në databazë. Zgjidhja teknike e ofruar përmes krijimit të vazhdueshëm të instancave të databazës është në vetvete një zgjidhje që kufizon performancën e sistemit dhe administrimin dhe mirëmbajtjen e tij.

3. Nuk plotësohen kërkesat e parashikuara në paragrafin 13.Kërkesat Funktionale/ kërkesa të përgjithshme:

- pika 007, faqe nr.18, e termave të referencës, pasi sistemi SQL Server Express Edition përveç madhësisë maksimale të përmendur më sipër, ka kufizime të tjera si në: Maksimumin e memories memory-optimized data për databazë 352 MB; Maksimumi i numrit të Cores : 4 Cores. Zgjidhja teknike e ofruar përmes krijimit të vazhdueshëm të instancave të databazës është në vetvete një zgjidhje që kufizon performancën e sistemit dhe administrimin dhe mirëmbajtjen e tij.

4. Nuk plotësohen kërkesat e parashikuara në paragrafin 14.1. Kërkesat funksionale për infrastrukturën hostuese, faqe 55 dhe 56, pasi:

- platforma HPE 380 e ofruar, suporton deri në 16 nyje. Autoriteti kontraktor ka kërkuar platformë hostimi me suport për jo më pak se 60 nyje.
- Platforma HPE 380 appliance e ofruar për cdo njësi është 4U . Autoriteti kontraktor ka kërkuar platformë hostimi për cdo njësi jo më shumë se 2U hapësirë 19”’.
- Platforma HPE 380 nuk suporton miksim të modeleve të ndryshme brenda të njëjtës familje të produktit të ofruar. Autoriteti kontraktor ka kërkuar platformë hostimi me mundësi për zgjedhje fleksible mes modeleve të ndryshme brenda të njëjtës familje. Ndërtim clusteri me modele të njëjtë apo të ndryshëm.

- Platforma HPE 380 nuk suporton kompresim dhe dedublikim. Autoriteti kontraktor ka kërkuar platformë hostimi me efikasitet maksimal të përdorimit dhe ruajtjes së të dhënave, përmes mekanizmave si all flash storage, dedublikim, kompresim dhe “integrated unused data erasure” në makina live VM.
- Platforma HPE nuk suporton offloaded antivirus dhe antimalware për makinat virtuale. Autoriteti kontraktor ka kërkuar platformë hostimi që suporton offloaded antivirus dhe antimalware për makina virtuale.
- Nuk është paraqitur asnjë e dhënë mbi mundësitë që ofron pajisja HPE 380 për RPO-në e saj. Autoriteti kontraktor ka kërkuar platformë hostimi me RPO të konfigurueshëm nga 5 minuta në 24 orë, mbi bazë VM.

5. Nuk plotësohen kërkesat e parashikuara në paragrafin 4.2 Detyrat specifike/ Faza IV/ faqe nr.12 e termave të referencës, pasi :

- në ofertën teknike nuk janë paraqitur plani i detajuar i dizenjimit të infrastrukturës hostuese dhe raportet e parashikuara të optimizimit të performancës dhe inxhinjerizimit të sistemit. Autoriteti kontraktor ka kërkuar që Operatori ekonomik të paraqesë një plan të detajuar për dizenjimin dhe implementimin e infrastrukturës hostuese, së bashku me raportet e parashikuara të optimizimit të performancës dhe inxhinjerizimit të sistemit.

6. Nuk plotësohet kërkesa që çdo e drejtë mbi kodin burimor t’i kalojë Autoritetit Kontraktor, paragrafi 12, Të drejtat e aplikacionit, faqe nr.16 e termave të referencës, pasi :

- Microsoft NAV është një produkt që bazohet në licensim dhe jo në shitje, dhe të drejtat maksimale që mund të garantojë operatori ekonomik janë ato të ashtuquajturat Extensions të zhvilluara prej atij vet, ndërsa të drejtat e kodit bazë burimor nuk mund t’i kalohen Autoritetit Kontraktor.

- Në prokurën e posacme dt 15.12.2016 me nr 1043 Rep dhe Nr 143 Kol është përcaktuar se shoqëria “Infosoft Systems” do të jetë përfaqësuesi i bashkimit të shoqërive **“Infosoft Systems” shpk & “ikub INFO” shpk** ku Z. Grigor Joti do të jetë përfaqësues ligjor i kësaj shoqërie.
- Në ekstraktin e shoqërisë Infosoft Systems Z. Grigor Joti nuk figuron as në statusin e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë dhe as në statusin e administratorit të shoqërisë. Shoqëria “Infosoft Systems” ka paraqitur një vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë tregëtare Nr.60 dt 22.04.2016 i cili nga verifikimet e kryera nuk është pasqyruar në ekstraktin historik të kësaj shoqërie duke rënë në kundërshtim edhe me vetë dispozitivin e këtij vendimi ku parashikohet depozitimi i këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit.

3. Operatori ekonomik “Intracom Telecom Albania” shpk S’kualifikohet

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “**Intracom Telecom Albania**” shpk, nuk ka respektuar fondet përkatëse për zerat e preventivit të cmimeve sic është parashikuar në Dokumentat standarte të tenderit si dhe nuk ka paraqitur dokumenta për përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit/ të Kualifikimit/ Kapaciteti ekonomik dhe financiar/Kapacitetit teknik sic është parashikuar në Dokumentat Standarte të Tenderit.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa në tërësi e dokumentacionit ligjor dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “ **Intracom Telecom Albania**” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor dhe teknik kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e përgjithshme dhe të Veçanta të Kualifikimit, te përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor ne dokumentat e tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4. Operatori ekonomik “C.C.S” shpk S’kualifikohet

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se operatori ekonomik “C.C.S” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar tek kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “C.C.S” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

5. Operatori ekonomik “iCOM” shpk S’kualifikohet

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik nuk ka respektuar fondet përkatëse për zerat e preventivit të cmimeve sic është parashikuar në Dokumentat standarte të tenderit ku janë ndare specifikisht fondi që percakton koston e zhvillimit dhe implementimit te projektit dhe fondi që percakton koston e mirëmbajtjes.
- Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik konstatohet se nuk janë paraqitur prej tij dokumenta për përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit sic është parashikuar në Dokumentat Standarte të Tenderit.

- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentat për përmbushjen e kriterëve të vecanta të kualifikimit/Kapaciteti ekonomik dhe financiar/Kapacitetit teknik siç është parashikuar në Dokumentat Standarte të Tenderit.

6. Operatori ekonomik “IMB- Instituti i Modelimeve ne Biznes” s’kualifikohet

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “ **IMB-Instituti i Modelimeve në Biznes**” shpk ka paraqitur vetëm ekstraktin e thjeshtë, ekstraktin historik, vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve fiskale. Ndërkohë ky operator nuk ka paraqitur dokumentat për përmbushjen e kriterëve të vecanta të kualifikimit/Kapaciteti ekonomik dhe financiar/Kapacitet teknik siç është parashikuar në Dokumentat Standarte të Tenderit.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa në tërësi e dokumentacionit teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “**IMB-Instituti i Modelimeve në Biznes**” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin teknik kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë “**Communication Progress**” shpk me adresë: Adresa: Rruga “Dritan Hoxha”, Pallati M.C Inerte, kati I, Laprakë, Tiranë, se oferta paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa t.v.sh **37.990.000 (tridhjetë e shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitörja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesmarrëse në këtë procedure prokurimi në mbështetje të nenit 63 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, nuk është paraqitur asnjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktor në lidhje me këtë procedurë prokurimi.